



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 27, datë 28.02.2022

PËR

**MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLOREN NR. 79, DATË 31.08.2015 “PËR
MIRATIMIN/LICENCIMIN E PERSONAVE PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARINË E
AGJENTIT NË SIGURIME, SI DHE RASTET E MOSPRANIMIT TË REGJISTRIMIT
TË TIJ DHE REFUZIMIT TË LICENCËS”, E NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e një ndryshimi në Rregulloren nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, e ndryshuar, si më poshtë:**

Pika 2, e nenit 13, ndryshon si vijon:

“2. Autoriteti nëse vëren mangësi apo pasaktësi në dokumentacionin e paraqitur, apo nëse e gjykon të nevojshme, njofton kërkesin për miratim/licencim për plotësimin e tyre brenda një afati 30 ditor. Ky afat mund të zgjatet edhe me 30 ditë të tjera për arsye të justifikuara. Nëse pas përfundimit të afatit, nuk plotësohet dokumentacioni, shqyrtimi i kërkesës/aplikimit ndërpritet. Në rast riaplikimi, dokumentacioni duhet të depozitohet nga e para.”

- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE